Sekuestrohet sasi e konsiderueshme e drogës në Prishtinë, arrestohen katër persona

14 janar 2024, 10:34

Shpërndaje në

Policia e Kosovës ka njoftuar se të shtunën ka realizuar një operacion antidrogë në Prishtinë, pas një hetimi disa mujor.

Siç ka bërë të ditur Policia, fillimisht ishte ndaluar në rrugën "Ernest Koliqi" një veturë BMW të cilën e drejtonte i dyshuari Y.A. (1997) dhe gjatë kontrollit i janë gjetur 1100 euro dhe tre telefona celularë.

Më pas gjatë kontrollit në shtëpinë e të dyshuarit Y.A. janë hasur në oborr tre persona U.G. (1999), F.Sh (1999) dhe F.H. (1998).

"Me të hyrë brenda oborrit një tjetër i dyshuar me iniciale (F.H.) 1998 ka filluar të ik nga vendi i ngjarjes dhe ka hedhur në oborrin e shtëpisë së fqinjit një qese të mbushur me substancë të dyshuar narkotike e cila më vonë pas matjes ka rezultuar me peshë (266.8) gramë. Hetuesit e antidrogës pas disa metrave ndjekje kanë arritur që ta ndalojnë dhe arrestojnë të dyshuarin e lartcekur me iniciale (F.H.) 1998, ku gjatë kontrollit të tij është gjet një sprej me mbishkrim "Nato" një telefon (IPHON) dhe 120 euro para", ka njoftuar Policia.

Gjatë realizimit të operacionit të bastisjes dhe kontrollimit të shtëpisë së të dyshuarit (Y.A.) janë gjetur: 10 paketime të mbushura me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë me peshë (590.6) gramëm një qese e mbushur me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë me peshë (12.29) gramë, një qese e mbushur me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë me peshë (1.75) gramë, një qese e vogël e mbushur me substancë të dyshuar narkotike të llojit kokainë me peshë (0.39) gramë, katërmbëdhjetë paketime të mbushura me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë me peshë (25.2) gramë, një armë zjarri me një karikator dhe tre fishekë, një qese e mbushur me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë me peshë (80.1) gramë, dy peshore digjitale të cilat shërbejnë për matje në sasi të vogla, para të gatshme (56.90) euro, pesëmbëdhjetë copë fishekë, nëntë telefona celularë, dy këllefë të revoles, një kuti e armës me mbushës dhe një karikator

Po ashtu gjatë kontrollimit të një shtëpie të pabanuar dhe në oborrin e saj, që gjendej përball shtëpisë së të dyshuarit (Y.A.) që dyshohet se është shfrytëzuar nga të dyshuarit janë gjetur dhe sekuestruar: një qese e mbushur me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë me peshë (1kg e 37.8gr)m një qese e mbushur me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë me peshë (157.4gr.), një qese e mbushur me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë me peshë 248.2 gramë, një granatë dore.

Dy nga të dyshuarit janë dërguar në mbajtje për 48 orë.

"Në vend të ngjarjes ka dalë forenzika rajonale e Prishtinës, e cila ka bërë fotografimin dhe konfiskimin e të gjithave dëshmive të gjetura si prova materiale. Në kuadër të këtij operacioni është kontrolluar edhe një banesë në rr. "Bedri Berisha" në Prishtinë, por nuk është gjetur diçka e dyshuar. Të dyshuarit janë intervistuar dhe me vendim të prokurorit dy prej tyre janë dërguar në mbajtje për 48 orë. Rasti është duke u hetuar nga njësitet kompetente të antidrogës", thuhet nga Policia.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Kapen pesë pushkë gjysmautomatike në Prizren
Gjobitet shoferi i dehur në Ferizaj
U tremb nga tërmeti, 18-vjeçari në Lushnjë humb jetën pasi u rrëzua nga shkallët
Kërcënoi se do t'i djegë zyrat e një kompanie, arrestohet i dyshuari në Vushtrri
Një person gjendet i vdekur në Dragash
Katër nga 15 të lënduarit nga bombola e gazit në Mitrovicë në gjendje më të rëndë
I dyshuari për narkotikë në veri godet policin me veturë dhe ikën

Taboola Feed

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë



Invest in Your Future with a Dubai Apartment for Sale
Dubai Apartments | Search Ads | Sponsored
Search Now

Some practical tips for when your key breaks into the lock
Women's Method | Sponsored

Pllakat e reja të murit prej gome nuk kërkojnë instalim (Kërko këtu për pllaka)
Pllaka muri gome | Kërko reklama | Sponsored

Unsold Prefabricated Cabins With Toilet And Bath Cost Almost Nothin...
Unsold Prefabricated Cabins | Sponsored
Learn More

Villas For Sale in Dubai Might Surprise You
Dubai Villas | Sponsored
Learn More

TË TJERA

Katër raste të dhunës ndaj familje gjatë 24 orëve të fundit

Tri raste të falsifikimit të parasë, policia nis hetimet

"U nis në drejtim të Serbisë dhe u zhduk", gjakovarja raporton vëllain e zhdukur nga nëntori

Gjendet pa shenja jete personi që u zhduk para dy ditësh në Baicë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e kërkyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të keté gabime!